LEGALIZIMET

Kompensimi i pronarëve, qeveria ndryshon VKM-të e mëparshme

Zbardhet lista, korrigjohen emra pronarësh dhe sipërfaqja e kompensuar për efekt legalizimesh

► FAQE 12-14

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI IX - NR. 95 (2618) | E ENJTE, 25-04-2019 | www.shqiptarja.com

EKSKLUZIVE/ SHIFRAT ZYRTARE

PROTESTAT E PD-LSI DERI TANI U KANE KUSHTUAR 640 MLN LEKE SHQIPTAREVE

Zbardhet kosto financiare dëmet e shkaktuara nga protestat e dhunshme të opozitës joparlamentare, nga pagat e orëve shtesë të policëve deri tek dëmtimet e ndërtesave qeveritare. Bashkia e Tiranës 7 gjoba PD-së vlerë 25 mln lekë

NGA ADRIATIK DOÇI

► FAQE 4-5

ZBARDHET DESHMIA

I PENDUARI I GRABITJES SE RINASIT: SI ME BENE OFERTEN ÇALA E MURATAJ NE NJE DREKE NE KAVAJE

Alkond Bengasi tregon drekën në Kavajë, përmend dhe dy kosovarë "Daja" e "Tani". Edhe një ish-police pjesë e bandës. Edlira Bici, dogji furgonin në Bathore për të çorientuar policinë

► FAQE 2-3

PERIFERI

NGA ALBA MALLTEZI

Kur të vdesë Njëshi që kemi në kokë

Edhe tani, akoma, nuk e kemi të qartë se "kush" e bën e "kush" do ta bëjë Shqipërinë. Ka muaj që jemi futur në një gjendje jo të mirë debati, konfliktuale, ku mbahen peng shumë çështje të rëndësishme që do të na bënin të ecnim përpara, por ka diçka që na mban në vend, ose na kthen në të njëjtën pikë.

vijon në faqen 16

MEDITIME

Antuan

NGA EDISON YPI

► FAQE 16

ANALIZA

Ëndërra e fshehur e fashistëve për t'u hakmarrë

NGA BAJRAM PEÇI

► FAQE 16

MBLEDHJA E KRYESISE

Spiropali: Nuk negociojmë, PD ka lënë në rrugë zgjedhësit

Rama mbledh Kryesinë e PS, mazhoranca përgatitet për zgjedhjet, nuk ka shtyrje

► FAQE 7

FURTUNE NE ADMINISTRATE

Shkarkohen 600 punonjës, Edi Rama: Nuk ishin të denjë

Kryeministri Rama thirrje qytetarëve: Na ndihmoni që të identifikojmë grabitqarët

► FAQE 7

NDERIMI PAS VDEKJES

MJESHTRI KODRA SHPALLET MISIONAR DHE AMBASADOR I PAQES NE SHBA

Kujtimet me piktorin e madh, çfarë më ka rrëfyer gjatë një interviste

► FAQE 10-11

NGA NADIRE BUZO

Cyan magenta yellow black



Tao Çela

Eldi Çela

Klemend Çela

Elton Pikli

Dëshmia e Bengasit: Si më bënë ofertën Çala e Murataj në një drekë në Kavajë

Bashkëpunëtori i prokurorisë tregon si u takua me Murataj dhe dy Kosovarë "Daja" e "Tani"

Alkond Bengasi,kushëriri i Klemend Çala,ka rrëfyer para prokurorëve dhe oficerëve të policisë mënyrën se si ishte gjendur përballë ofertës për të modifikuar furgonin, i cili do përdorej për grabitje në Rinas. Bengasi u ka treguar grupit hetimor se me Admir Murataj dhe dy shtetas kosovarë, janë takuar në zonën e Shkëmbit të Kavajës, ku dhe kanë drekuar. Pikërisht në këtë vend, i është hedhur oferta financiare për të bërë modifikimin e furgonit, i cili është marrë në Durrës.Bengasi është shprehur se kontaktin e parë dhe porosinë për modifikimin e makinës e ka pasur me dy kushërinjtë e tij, Klement dhe Eldi Çala. Ai ka treguar edhe takimin me kreun e grupit Admir Muratajt dhe kërkesën e tyre për të bërë modifikimin e furgonit më të cilin grabitën thasët me euro në Rinas. "Fillimisht nuk pranova dhe nuk doja të largohesha nga Elbasani. Por duke qenë se unë punoja në një servis ata më kërkuan t'i shoqëroja në Kavajë, ku do të merrnim një furgon. Pranova dhe shkuam tek "Shkëmbi i Kavajës". Aty na prisnin 3 persona për drekë. Një u prezantua si Admir Murataj, ndërsa dy të tjerët ishin nga Kosova. Një prej tyre e thërrisnin "daja" ndërsa tjetrin "Tani".

Alkond Bengasi

"MJETET DO PËRDORESHIN PËR GRABITJE"

Alkond Bengasi vijon më tej në dëshminë e tij duke deklaruar se: "pasi hëngrën dreke morëm furgonat, të cilët më pas i modifikoi". "Më vonë mësova se mjetet do të përdoreshin për grabitje"-shtoi ai. Bengasi rrëfeu për hetuesit emrat e personave të përfshirëve dhe mënyrën se si furgoni u modifikua në Elbasan 2 muaj para goditjes në pistën e aeroportit të Rinasit. Me këtë rrëfim të marrë nga Bengasi ditën e premte kur ai është ndaluar në qytetin e Elbasanit, hetuesit shkuan më pas tek të arrestuarit e tjerë Oltjon Veseli, Renaldo Sula dhe Saimir Çela. Deri tani për grabitjen në Rinas janë arrestuar pesë persona Oltion Veseli dhe Elton Pikli, të dy nga Kruja dyshohet se janë autorë, ndërsa Alkond Bengasi (i penduar i drejtësisë), Saimir Çela dhe Renaldo Sula akuzohen si bashkëpunëtorë. Në kërkim janë Talo Çela, Klement Çela, Eldi Çela, Marenglen Hoxha, ish-punonjës policie, Aleks Pepa dhe dy të tjerë, që sipas dashmisë së Alkond Bengasit janë dy shqiptarët nga Kosova. Ndërkohë që koka e grupit, Admir Murataj nga Tropoja, i arratisur në 2013 nga burgu grek u vra gjatë shkëmbimit me policinë. Dy ditë më parë në pikën e kalimit kufitar u arrestua një tjetër grabitës Elton Pikli nga Kruja, i cili punon si kasap.

PIKLI NË KËRKIM PËR AKUZËN E FALSIFIKIMIT

"Shqiptarja.com" mëson se Pikli ka qenë i shpallur në kërkim nga prokuroria e Tiranës, e cila ka hapur një çështje penale kundër tij, duke e akuzuar për falsifikimin e një pasaporte. Emri i tij duket se ka dalë pas dëshmisë së të penduarit, ose një tjetër dyshim është se mund ti kenë dalë gjurmët e gishtave te furgoni që autorët dogjën pas grabitjes së 5.7 milion eurove. Pas arrestimit policia ka kryer kontrolle në banesën e tij në Krujë, por nuk janë gjetur as armë dhe as para. Elton Pikli punon në Krujë si kasap dhe njihet si komshi i Dash Kupës, ku dhe janë rritur së bashku në Krujë. Ndërkohë para tre ditësh u arrestua Oltion Veseli, ndërsa dje Elton Pikli, të dy nga Kruja, autorë të grabitjes në Rinas. Me arrestimin e fundit shkon në pesë numri i personave të kapur (dy autorë dhe tre bashkëpunëtorë), ndërsa shtatë vijojnë që të jenë ende në kërkim, mes tyre Klement Çala, vëllai i tij Eldi Çala dhe një ish-polic nga Elbasani, Mareglen Hoxha. Hetimet për autorët e tjerë janë duke u kryer edhe me autoritetet bullgare, pasi dyshohet se Bullgaria ishte një ndër bazat e Aleks Pepës një prej të kërkuarve për grabitjen e parë brenda aeroportit të Rinasit në 2016.

Dy kosovarë

Alkond Bengasi, u ka treguar grupit hetimor se me Admir Murataj dhe dy shtetas kosovarë, janë takuar në zonën e Shkëmbit të Kavajës, ku dhe kanë drekuar.

Arrestimet

Me këtë rrëfim të marrë nga Bengasi ditën e premte kur ai është ndaluar në qytetin e Elbasanit, hetuesit shkuan më pas tek të arrestuarit e tjerë Oltjon Veseli, Renaldo Sula dhe Saimir Çela.

Me bullgarët

Hetimet për autorët e tjerë janë duke u kryer edhe me autoritetet bullgare, pasi dyshohet se Bullgaria ishte një ndër bazat e Aleks Pepës një prej të kërkuarve për grabitjen e parë brenda aeroportit të Rinasit në 2016.

Admir Murataj

Ish-policja Bici pjesë e bandës që grabiti 5.7 mln euro

Edlira Bici, çorientoi policinë gjatë ndjekjes së grabitësve, dogji furgonin

Grupi i grabitësve në Rinas ka patur si pjesë të tij edhe një ish-efektive të Policisë së Shtetit. Edlira Bici ish-efektivja e patrullës së komisariatit Kombinat është bërë pjesë e grupit ku pasditen e 9 prillit 2019 çorientoi forcat e policisë që ishin në ndjekje. Sipas informacioneve të siguruara, Bici ka lënë policinë në vitin 2019 dhe më 9 prill 2019, ajo është personi që ka djegur furgonin në Bathore, një furgon mercedez Benz Vito ngjyrë i bardhë, i ngjashëm me atë që u larguan me 7 thasë me para 4 të mbijetuarit. Kjo makine nuk kishte lidhje me grabitjen, por u dogj nga ana e ish-polices në mënyrë që bashkëpuntorët e saj të shpërqëndroheshin, teksa grabitësit largoheshin me një tjetër automjet në një drejtim tjetër. Ndërkohë Bici është shpallur në kërkim por ende s'dihet se si ajo është bërë pjesë e grupit në të cilin ishte dhe Admir Murataj, Oltjon Veseli, Renald Sulaj, Saimir Çela, Klement dhe Eldi Çala. Në kërkim në lidhje me grabitjen e ndodhur në aeroportin e Rinasit është edhe një tjetër ish-punonjës policie, Marenglen Hoxha, i cili dyshohet të ketë dhënë infromacion tek grabitësit për furgonet që transportonin paratë.

TRE TË ARRESTUARIT MBETEN NË BURG

Ndërkohë gjatë ditës së djeshme Gjykata e Krimeve të Rënda ka lënë në burg ish-imamin radikal Oltian Veseli 38 vjeç, banues në Krujë, që është njëri nga të dyshuarit si pjesë e grupit të pesë grabitësve dhe dy bashkëpunëtorët, Renaldo Sula 25 vjeç, Saimir Çela 28 vjeç. Seanca gjyqësore është zhvilluar me dyer të mbyllura. Dy ditë më parë gjykata la në burg Alkond Bengasin, i cili pranoi që të bëhej bashkëpunëtor i drejtësisë duke treguar shokët. Olti Veseli që dje u la në burg me dy të tjerët është myslimani radikal që u përzgjodh nga "Al Kaeda" gjatë kohës që iku nga Jemeni në Afganistan. Nga izolimi në burgjet famëkeqe të Afganistanit, te hetimet e amerikanëve, Shqiptarja.com zbuloi të kaluarën kriminale të tij. Për rreth 1 vit, para se të nisej në Afganistan, Veseli, ka qenë edhe imam i vetëshpallur në xhaminë e Krujës, në zonën e Kalasë. Ai nuk ka qenë asnjëherë imam i vendosur nga KMSH-ja në Krujë, por i vetëshpallur. Deri tani janë arrestuar pesë persona për grabitjen Oltion Veseli dhe Elton Pikli, të dy nga Kruja dyshohet se janë autorë, ndërsa Alkond Bengasi (i penduar i drejtësisë), Saimir Çela dhe Renaldo Sula akuzohen si bashkëpunëtorë. Në kërkim janë, Talo Çela, Klement Çala, Eldi Çala, Marenglen Hoxha, ish-punonjës policie, Aleks Pepa dhe dy të tjerë.

Edlira Bici

Ndërkohë që koka e grupit, Admir Murataj nga Tropoja, i arratisur në 2013 nga burgu grek u vra gjatë shkëmbimit me policinë.

PERSONA TË SHPALLUR NË KËRKIM
Talo Çela, nga Elbasani, (dyshohet të jetë autor direkt në grabitje) pronar i vilës ngjitur me servisin ku u modifikua furgoni
Klement Çala 31 vjeç nga Elbasani, i shpallur në kërkim për grabitjet që në vitin 2015
Eldi Çala (ka blerë servisin në Karakullak ku u modifikua furgoni i grabitjes) - bashkëpunëtor, vëllai i Klement Çalës
Marenglen Hoxha, ish-punonjës policie (dyshohet të ketë dhënë infromacion tek grabitësit për furgonet që transportonin paratë)
Aleks Pepa nga Elbasani i shpallur në kërkim për grabitjen e parë brenda aeroportit në qershor 2016
Edlira Bici ish-efektive e patrullës së komisariatit Kombinat
PESË PERSONA TË ARRESTUAR
Oltion Veseli 38 vjeç nga Kruja (dyshohet autor i grabitjes)
Elton Pikli 40 vjeç nga Kruja (dyshohet autor i grabitjes, me profesion kasap)
Alkond Bengasi, 34 vjeç nga Elbasani (i penduar i drejtësisë, dyshohet bashkëpunëtor), me banim në Tiranë
Saimir Çela 28 vjeç nga Kajani i Elbasanit (bashkëpunëtor)
Renaldo Sula 25 vjeç nga Elbasani (bashkëpuëntor)
Mbeti i vrarë ***Admir Murataj***

KOSTO E DËMEVE TE PROTESTAVE TË OPOZITES NË TIRANË SIPAS TE DHENAVE ZYRTARE TE BASHKISË	
PROCESVERBAL MBAJTUR ME 15 PRILL 2019	
Vendi bulevardi deshmoret e kombit	
Pastrim grilave tee dritareve	27600 lekë
Pastrim i bordurave prej mermeri	72 000 lekë
Pastrim I shkallës prej mermeri	144 000 lekë
Shuma :	243.600 lekë
Vendi bulevardi deshmoret e kombit	
Pastrim fasade prej pllakash mermeri dekorativ deri në 18 m lartësi:	1 672 000 lekë
Pastrim kornize mermeri e dritareve dhe dyerve :	198 000 lekë
Gjithsej:	1 870 000 lekë
PROCESVERBAL MBAJTUR ME 17 PRILL	
Vendi: shëtitorja Murat Toptani	
Shtylla:	19 044 lekë
Ndriçues dekorativ 5 copë	171 294 lekë
Gjithsej:	190 334 lekë
PROCESVERBAL MBAJTUR ME 15 PRILL	
Pastrim I trotuarit pergjatë fasadës së objektit:	48600 lekë
Pastrim I rrjetave te dritareve ne katin bodrum	10 800 lekë
Gjithsej :	59 400 lekë
PROCESVERBAL MBAJTUR ME 16 PRILL	
Pemë lofate	12 000 lekë
Pemë Arizona	21 000 lekë
Lule decorative	88 500 lekë
Vazo decorative	15 000 lekë
Gjithsej	136 500 lekë
PROCESVERBAL MBAJTUR ME 16 SHKURT	
Dëmtim të hapësirës publike, dhe të gjelbër	
Dëmi:	20 000 lekë
PROCESVERBAL 15 PRILL	
Shëtitorja murat toptani	
Dëmtim I shtyllave apo ndriçuesve :	20 000

GJOBAT NGA BASHKIA TIRANË PËR PARTINË DEMOKRATIKE		
16 shkurt	dëmtimi I hapësirës së gjelbër	20.000 lekë
16 shkurt	dëmtimi I pemëve decorative	136.500 lekë
15 prill	kosot e pastrimit të Kryeministrisë	243.600 lekë
15 prill	dëmtimi I shtyllave Rr.”Murat Toptani”	20.000 lekë
15 prill	kosto e pastrimit	59.400 lekë
15 prill	kosto e pastrimit	1.870.000 lekë
17 prill	riparimi I shtyllave	190.334 lekë
GJOBAT NË TOTAL		**2539834 LEKË**

Protestat e PD-LSI u kushtojnë 640 mln lekë shqiptarëve

Ja të gjitha dëmet e shkaktuara nga protestat e dhunshme dhe kostoja e tyre, Bashkia e Tiranës 7 gjoba PD me vlerë 25 milionë lekë



BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË TREGUT DHE SHËRBIMEVE

№ 000101

PROCESVERBAL SHOQËRUES

I PËRCAKTIMIT TË DËMSHPËRBLIMIT MBI KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

I mbajtur sot, më datë 15/04/2019, më orën ___/___ nga specialistët e Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Shërbimeve, pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë

NDAJ SUBJEKTIT / INSTITUCIONIT

Emri subjektit/ institucionit/ qytetari: PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE
Veprimtaria ekonomike: POLITIKE
Emri administratorit:
Mbiemri administratorit:
NIPT-i: K51911900 9E
Adresa aktivitetit: Rruga Blv. "Zhan D'Ark" ndërtesa 11 hyrja ap. Tiranë

Adresa e vendndodhjes ku është kryer dëmi: Blv. "Deshmorët e kombit"

Nga verifikimet, ka rezultuar se subjekti/ institucioni/ qytetari ka kryer kundërvajtjen administrative dhe ka shkaktuar dëmin, i cili llogaritet sipas formulës Dm=TSDm x KRb

Pastrim i grilave të dritareve : 23 m² x 1.200 = 27.600
Pastrim i bordurave prej mermeri të rampes : 40 m² x 1.800 = 72.000
Pastrim i shkallës prej mermeri : 80 m² x 1.800 = 144.000

Mbështetur në dispozitën/ at ligjore, si më poshtë:

1. V.K.B nr. 156, dt. 21/12/2018, neni 17, pika ___, gërma ___.
2. ___ nr. ___, dt. ___/___/___, neni ___, pika ___, gërma ___.
3. ___ nr. ___, dt. ___/___/___, neni ___, pika ___, gërma ___.

Subjekti/institucioni/qytetari i mësipërm ka detyrimin për të paguar dëmin e shkaktuar në masën 243.600 (dyqind e dyzet e tre mijë e gjashtë qind) lekë.
Pagesa duhet të kryhet jo më vonë se 10 ditë nga data e njoftimit të vënies së gjobës së dëmshpërblimit mbi kundërvajtjet administrative.
Në rast të kundërt, me kalimin e afatit, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 % të masës së gjobës.

Specialistët e D. M. T. SH-së
1. Arbër Bara
2. Armand Hyseni
3. ___

Kundërvajtësi: PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE
Përfaqësuar nga:
☐ Refuzoi firmën

Konstatuar nga DPN.3, formalizuar nga AMK.

Dërguar me rastë.

Adriatik Doçi
TIRANE

Protestat e njëpasnjëshme të opozitës jo-parlamentare, të karakterizuara nga aktet sistematike të dhunës dhe vandalizmat, përpos dëmtimit të imazhit të Shqipërisë, kanë një kosto ekonomike për taksapaguesit shqiptarë. Shqiptarja.com ka siguruar të dhënat zyrtare të Ministrisë së Brendshme dhe të Bashkisë së Tiranës mbi koston e protestave të opozitës, për periudhën shkurt-prill 2019, kosto e cila pritet të marrë përmasa të tjera gjatë javëve në vijim, pasi PD-LSI kanë vendosur përshkallëzimin e aksionit të tyre radikal, me qëllim detyrimin e shumicës për të larguar kryeministrin. Deri më sot protesta e dhunshme të PD-LSI u kanë kushtuar shqiptarëve 640 milionë lekë. Vetëm Policisë së Shtetit, e cila paguhet nga të gjithë taksapaguesit, protestat e deritanishme të opozitës i kanë kushtuar 61 838 138 lekë. Konkretisht, pashijet e dëmtuara nga dhuna e protestuesve, gjatë të gjitha protestave, ku përfshihen kamera trupi policie, mburoja plastike, skafandra, xhamat dhe tapiceria e një mjeti policie, kanë kushtuar 776 600 lekë. Për çdo protestë të opozitës janë angazhuar mijëra punonjës policie, edhe jashtë orarit zyrtar të punës. Kostoja e orëve shtesë të uniformave blu, për menaxhimin e protestave të opozitë, sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme, është 60,361,538 lekë. Sipas të dhënave të siguruara nga Shqiptarja.com, për menaxhimin e protestave të PD-LSI, për periudhën shkurt-prill, janë angazhuar 14.182 punonjës policie, ndërsa llogariten 103 504 orë shtesë. Ndërkaq, kostoja e barrierave të vendosura nga policia para institucioneve



TË DHËNA PËR TUBIMET E ZHVILLUARA NE TIRANË GJATË MUAJVE SHKURT-MARS-PRILL 2019 NË TIRANË

	Lista e cështjeve	16.02.19	21.02.19	26.02.19	28.02.19	05.03.19	16.03.19	21.03.19	28.03.19	03.04.19	11.04.19	13.04.19	SHUMA
1	Forca policie të angazhuara	1392	1613	334	700	1529	1527	1613	1698	1621	757	1398	**14.182**
2	Orë pune shtesë	9742	12881	1336	5600	11418	9005	10879	11814	11340	8510	10979	**103.504**
3	Kosto e orëve shtesë (lekë)	5607620	7516764	801600	3360000	6629464	5258024	6321844	6874304	6518052	5106000	6367866	**60,361,538**
4	Mjete, pajisje policie të dëmtuara (barriera etj.)	2 kamera trupi policie	10 mburoja plastike 10 skafandra	2 xhama, tapiceria etj., mjeti i policisë MB 099AA DVP TR			5 mburoja plastike 4 skafandra					8 mburoja plastike 12 skafandra	**Shënim në fund**
5	Kosto e pajisjeve, mjeteve, barierave të dëmtuara	-	10 barriera të dëmtuara të Bashkisë TR	-	-	-	-	-	-	-	-	Barriera: 45 të dëmtuara, 15 të humbura, të Bashkisë TR	**70 cop x 10,000 lek = 700,000 lekë**
6	Punonjës policie të dëmtuar	3	-	-	-	4	3	-	4	-	-	4	**Shuma: 18 FLO – 4 DVP Tiranë - 14**

SQARIM PËR PIKËN 4:			
2	kamera trupi	x 110,000 lekë copa	= **220,000** lekë
23	mburoja	x 11,880 lekë copa	= **273,240** lekë
26	skafandra	x 9,360 lekë copa	= **243,360** lekë
2	xhama mjeti (tapiceria etj.)		= **40,000** lekë



BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË TREGUT DHE SHËRBIMEVE Nr 001201

PROCESVERBAL SHOQËRUES
I PËRCAKTIMIT TË DËMSHPËRBLIMIT MBI KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

I mbajtur sot, më datë 16/02/2019, më orën 19.15 nga specialistët e Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Shërbimeve, pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë

NDAJ SUBJEKTIT / INSTITUCIONIT

Emri subjektit/ institucionit/ qytetarit PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
Veprimtaria ekonomike POLITIKE
Emri administratorit
Mbiemri administratorit
NIPT -i
Adresa aktivitetit KS1911901001E
Rruga Dh. Zhan D'Ark ndërtesa 11 hyrja ap. 1 Tiranë
Adresa e vendndodhjes ku është kryer dëmi Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Nga verifikimet, ka rezultuar se subjekti/ institucioni/ qytetari ka kryer kundërvajtjen administrative dhe ka shkaktuar dëmin, i cili llogaritet sipas formulës Dm=TSDm x KRb

Pemë dafine 1 x 12,000 = 12000 dhe dekorative 295 x 300 = 88500
Pemë Arizona 3 x 7000 = 21000 Vazo dekorative 5 x 3000 = 15000

Mbështetur në dispozitën/ at ligjore, si më poshtë:
(specifikohet ligji/vendimi i KM-së/ vendimi i KB-së/ neni/ pika)

V.K.B nr. 156, dt. 21/12/2018, neni 12, pika 4, gërma a.
nr. ____, dt. ____/____/____, neni ____, pika ____, gërma ____.
nr. ____, dt. ____/____/____, neni ____, pika ____, gërma ____.

kti/institucioni/qytetari i mësipërm ka detyrimin për të paguar dëmin e shkaktuar në masën 136500 lekë.
duhet të kryhet jo më vonë se 10 ditë nga data e njoftimit të vënies së gjobës së dëmshpërblimit mbi kundërvajtjet trative.
ë kundërt, me kalimin e afatit, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 % të masës së gjobës.

itësi:
IA DEMOKRATIKE
nga:

Specialistët e D. M. T. SH-së
1. A. Shkupi
2. O. Bello
3. M. Halilaj
K. Kriza

PD-LSI bllokojnë sot akset kryesore, Soreca takon aleatët e Bashës

Opozita nis përshkallëzimin e protestave për të detyruar mazhorancën qeverisëse të dorëzojë pushtetin

Partia Demokratike, LSI dhe partitë e tjera opozitare do të zhvillojë sot në orën 18:00 protestën e radhës, e cila nuk do të jetë përpara Kryeministrisë dhe Kuvendit si në nëntë tubimet e tjera, por në akset kryesore që lidhin Jugun dhe Veriun e vendit me kryeqytetin për të paralizuar qarkullimin. Kjo formë protesta vjen pas vendimeve të PD-LSI për të përshkallëzuar aksionin politik, për të detyruar mazhorancën të pranojë kushtin për largimin e kryeministrit Edi Rama. Burime për Report Tv konfirmojnë pikat që opozita do të bllokojë nesër pasdite me rreth një orë. Në Elbasan, te rrethrrotullimi i Bradasheshit do të bllokohet aksi që lidh Juglindjen me Tiranën, zona e Jugut do të bllokohet në rrethrrotullimin e Sheqit të Fierit. Protestuesit nga Veriu i vendit do të grumbullohen në Milot. Një tjetër pikë do të jetë ajo te Shkëmbi i Kavajës dhe kryesorja te sheshi 'Shqiponja' për të bllokuar hyrjen në Tiranë. Për të diskutuar mbi detajet e protestës, Monika Kryemadhi zhvilloi dje një takim me kryetarët e degëve të LSI-së në rrethe. "LSI është e angazhuar në aksionin opozitar. LSI sa më pranë qytetarëve. Opozita e bashkuar kundër keqqeverisjes, varfërisë dhe largimit të të rinjve nga vendi. Lufta kundër varfërisë është prioriteti kryesor. Të gjithë në terren në komunikim të drejtpërdrejt me qytetarët", tha ajo. Ky është një skenar i përsëritur nga opozita, pasi edhe më parë ka bllokuar rrugët, ndërsa në 11 maj do të jetë protesta kombëtare para Kryeministrisë. Vitin e kaluar, po në këto arterie kryesore të vendit opozita bllokoi rrugët disa herë si shenjë e mosbindjes civile. Edhe tani, një vit më pas, opozita vijon që të kërkojë largimin e Ramës dhe krijimin e një qeverie tranzitore për të përgatitur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. PD dhe LSI kanë paralajmëruar se nuk do të lejojnë zhvillimin e zgjedhjeve lokale, ndërsa nuk u regjistruan në KQZ.

PIKAT QË DO TË BLLOKOHEN NGA OPOZITA

- Tiranë, rrethrrotullimi Shqiponja
- Durrës-Kavajë, Plepa Autostradë- përballë shtëpisë së pushimit
- Fier, rrethrrotullimi Sheq
- Elbasan, rrethrrotullimi Bradashesh
- Milot, karburanti në autostradë

Protesta

Partia Demokratike, LSI dhe partitë e tjera opozitare do të zhvillojë sot në orën 18:00 protestën e radhës, duke bllokuar akset kryesore që lidhin Jugun dhe Veriun e vendit.

Takimi

Krerët e LZHK, PAA, PBDNJ, PDK, PR, aleatë të PD dhe LSI do të zhvillojnë sot në orën 16:00 një takim me ambasadorin e Bashkimit Europian në Shqipëri Luigi Soreca.

TAKIMI ME AMBASADORIN E BE

Kriza politike në vend dhe vendimi i opozitës për të mos marrë pjesë në zgjedhjet vendore, kanë bërë që ndërkombëtarët të intensifikojnë takimet për gjetjen e një zgjidhje. Krerët e LZHK, PAA, PBDNJ, PDK, PR, aleatë të PD dhe LSI do të zhvillojnë sot në orën 16:00 një takim me ambasadorin e Bashkimit Europian në Shqipëri Luigi Soreca. Takimi ka në fokus situatën politike në vend dhe do të zhvillohet 2 orë përpara se opozita të nisë protestën e saj duke bllokuar disa nga akset kryesore kombëtare. Dy ditë më parë Soreca ka zhvilluar një takim kokë më kokë me kreun demokrat Lulzim Basha, në selinë blu, ku temë diskutimi ka qenë situata politike në vend dhe gjetja e një zgjidhje. Po dy ditë më parë, partitë aleate të PD dhe LSI janë takuar me ambasadorin e OSBE Bernd Borchardt, ku në fokus ishte vendimi i marrë nga opozita për bojkotimin e zgjedhjeve vendore të qershorit 2019.

Kostoja

Protestat e njëpasnjëshme të opozitës joparlamentare, të karakterizuara nga aktet sistematike të dhunës dhe vandalizmat, u ka kanë kushtuar deri më sot shqiptarëve 640 mln lekë.

shtetërore, por që janë dëmtuar nga protestuesit e dhunshëm gjatë konfrontimeve me policinë dhe sulmeve ndaj godinave shtetërore, është 700,000 lekë.

KOSTOJA PËR BASHKINË E TIRANËS

Dëmi që kanë shkarkuar protestuesit e dhunshëm në qytetin e Tiranës, sipas shifrave zyrtare të Bashkisë së Tiranës, është 2 539 834 lekë. Këtë shumë, Bashkia e Tiranës ia ka faturuar Partisë Demokratike, përmes 7 gjobave. Dëmi financiar konsiston në shkatërrimin e e shtyllave ndriçuese, gjelbërimit, pemëve etj. Sipas të dhënave, koston më të madhe përfshin dëmi që u është bërë fasadave të godinave shtetërore, sidomos fasadës së Kryeministrisë.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

TAKIMI / CASTALDO: DO NJOHIM PËRPJEKJET E SHQIPËRISË PËR REFORMAT

Ruçi takon zv.presidentin e PE: Shqipëria i ka bërë 'detyrat'

Ruçi
"Shqipëria i ka bërë të gjitha "detyrat e shtëpisë" për plotësimin e standardeve në pesë prioritetet kyçe që përcaktuan rekomandimet e Këshillit Europian dhe po vazhdojmë të përparojmë në zbatimin e reformave integruese".

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, priti dje Zëvendëspresidentin e Parlamentit Europian dhe Kryetar i Komisionit për Punët e Jashtme, Fabio Massimo Castaldo. Kryetari i Kuvendit i shprehu Castaldos mirënjohjen e vlerësimin për ndihmën dhe mbështetjen që Parlamenti Europian, dhe Italia i kanë dhënë Shqipërisë për nxitjen e perspektivës së integrimit evropian dhe për reformat gjithëpërfshirëse e transformuese që ka ndërmarrë. "Shqipëria i ka bërë të gjitha "detyrat e shtëpisë" për plotësimin e standarteve në pesë prioritetet kyçe që përcaktuan rekomandimet e Këshillit Europian dhe po vazhdojmë të përparojmë në zbatimin e reformave integruese, veçanërisht në reformimin e sistemit të drejtësisë, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe dekurajimin dhe zvogëlimin e kërkesave të azilkërkuesve në të gjitha vendet e BE-së. Vendimi pozitiv i Këshillit në Qershor 2019 do të ishte një moment vendimtar për të treguar gatishmërinë e BE-së për të ruajtur dhe forcuar perspektivën tonë evropiane, por edhe përkushtimin e BE-së ndaj Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Unë mendoj se Shqipëria, por edhe vetë BE, ka nevojë që vlerësimet pozitive të shumicës dërmuese të vendeve anëtare të mos errësohen dhe shvlerësohen nga paragjykimet e veçanta dhe interesat e brendshme elektorale të forcave politike që nuk e kanë aq për zemër as zgjerimin e BE-së, as vetë BE-në. Një vendim negativ në Qershor 2019 do të ngadalësonte procesin e integrimit të Shqipërisë dhe do të përcillte një mesazh dekurajues për vendin, shoqërinë dhe popullin tonë", tha Ruçi. Zëvendëspresidenti i Parlamentit Europian Fabio Massimo Castaldo, u shpreh se "Ne po luftojmë fort që në qershor të hapen negociatat dhe Shqipërinë e duam të parën e klasës dhe në krye të listës. Jam shumë i preokupuar nga qëndrimi i opozitës ndaj parlamentit dhe zgjedhjeve lokale sepse këto qëndrime dëmtojnë kohezionin politik brenda vendit. Megjithatë, pavarësisht këtyre qëndrimeve, Italia që është vendi im, po lobon fort për hapjen e negociatave në qershor. Ne nuk duhet të zhgënjejmë dhe dekurajojmë shqiptarët, por të njohim e vlerësojmë përpjekjet e Shqipërisë për reformat integruese, sidomos reformën e vështirë dhe unike në drejtësi. Kam qenë dhe do të jem personalisht dhe institucionalisht, si italian dhe evropian, për hapjen e negociatave me Shqipërinë në qershor 2019", tha Castaldo.

Shkarkohen 600 punonjës, Rama: Nuk ishin të denjë

Kryeministri thirrje qytetarëve: Na ndihmoni që të identifikojmë grabitqarët në administratën publike

Intensifikohet lufta kundër parazitëve dhe grabitqarëve në administratën publike. Kryeministri Edi Rama deklaroi dje se janë pushuar nga puna rreth 600 punonjës, pasi nuk kanë ofruar shërbim e duhur tek qytetarët. Në takimin e përjavshëm me qytetarët, që kanë gjetur zgjidhje më anë të portalit "Shqipëria që duam.al", kryeministri u shpreh se janë raportuar shumë raste nga qytetarët, të cilët nuk kanë marrë zgjidhje për problemin e tyre, por mbi të gjitha ka pasur edhe një sjellje aspak të hijshme nga ana e punonjësve që janë në vijën e parë të shërbimit. "Shumë njerëz që janë në vijën e parë me qytetarët sillen në mënyrë të padenjë dhe një nga vlerat e këtij procesi është ky, që rasti pasi trajtohet dhe zgjidhen vazhdon një hetim për vonesat dhe personat përgjegjës marrin ndëshkimin e duhur. Janë 600 individë, nga punonjës deri tek drejtues që janë pushuar nga puna se nuk kanë qenë të denjë në shërbimin e qytetarëve. Edhe nga konstatimet tona në bazë të rezultateve të punës së matshme, nga raportet dhe ankesat, por edhe marrja e perceptimit të qytetarëve, ka një perceptim që ndjehet tek shërbimet publike. Miku i famshëm që ishte ilaç tradicional për problemet në shtet, sot ka jo vetëm pamjen, por edhe trajtën e qeverisë. Qeveria miku më i madh i çdo qytetari", tha kreu i qeverisë.

Kryeministri Rama foli për reformën në zyrat e pronave. "Ne e kemi vendosur një bazë të re në punë e zyrave që merren me pronën dhe sot sikundër ju e dini, por mbase dikush ende nuk e ka informacionin se tashmë nuk kemi një zyrë ALUIZNI dhe një Hipoteke, por një zyrë Kadastre. Kjo agjenci sapo është krijuar, por natyrisht kërkon kohën e duhur për t'u harmonizuar. Do të kemi shumë më pak pengesa mes dy strukturave dhe hendeku tashmë nuk ekziston", tha Rama.

APELI PËR QYTETARËT

Kryeministri kishte një mesazh për qytetarët, teksa i ftoi që të ndihmonin qeverinë për identifikimit të grabitqarëve në administratën publike. "Është qeveria miku më i madh i çdo qytetari. Nuk ka mik më të madh dhe më efikas se qeveria, pasi ajo mund ta bëj për secilin qytetar. Grabitqarët dhe parazitët nuk mund t'i identifikojmë pa ndihmën tuaj. Është koha që të ndajmë të thatin nga i njomi. Më vjen mirë të them se numri total i ankesave në platformë, ka kaluar 41 mijë dhe po afrohen në 30 mijë rastet e zgjidhura. Kjo tregon se ku e kemi çuar komunikimin me njerëzit. Komunikim të drejtpërdrejtë me njerëzit që nuk jetojnë në kazan, me njerëzit që nuk rrinë kafeve dhe nuk bëjnë llogje. Ne vërtetë kemi marrë votën e tyre, por qëndrojmë 24 me ta dhe në çdo sekondë që ata na kërkojnë", tha Rama.

Rama
"Janë 600 individë, nga punonjës deri tek drejtues që janë pushuar nga puna se nuk kanë qenë të denjë në shërbimin e qytetarëve. Miku i famshëm që ishte ilaç tradicional për problemet në shtet, sot ka jo vetëm pamjen, por edhe trajtën e qeverisë".

Apeli
"Nuk ka mik më të madh dhe më efikas se qeveria, pasi ajo mund ta bëj për secilin qytetar. Grabitqarët dhe parazitët nuk mund t'i identifikojmë pa ndihmën tuaj. Është koha që të ndajmë të thatin nga i njomi".

Fleckenstein për vizat me Holandën: E motivuar politikisht

Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian, Knut Fleckenstein, ka komentuar vendimin e shumicës në Parlamentin Holandez për të rekomanduar pezullimin e vizave për shqiptarët. Në një reagim për gazetën "TemA", eurodeputeti gjerman gjykon se kjo është lëvizje e motivuar politikisht para zgjedhjeve në Parlamentin Europian dhe e mbështetur nga disa politikanë shqiptarë. "Unë mendoj se kjo është një lëvizje e motivuar politikisht nga Parlamenti holandez përpara zgjedhjeve të Parlamentit Europian në maj. Unë supozoj se mbështetet gjithashtu edhe nga disa politikanë shqiptarë", shprehet Fleckenstein. I pyetur nga gazetari Andrea Danglli se si do të ndikojë ky vendim në procesin e hapjes së negociatave, eurodeputeti e

përjashton rrezikun që mund t'i vijë Shqipërisë. "Unë nuk shoh absolutisht asnjë rrezik që liberalizimi i vizave mund të pezullohet për qytetarët shqiptarë. Jam i befasuar që parlamentarët holandezë besojnë se krimi i organizuar ka nevojë për vizë për t'u penguar", nënvizon eurodeputeti Knut Fleckenstein.

CORRECTOR
BAILIFF SERVICE

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E III-TË, PËR SHITJEN E PASURIVE TË PALUAJTSHME:

• Njësi me Nr. Pasurie 2/346-N1, Vol.27, Fq.7, sip. 41.2 m², z.k 8534, me adresë Lagjja Apolonia, regjistruar në ZVRPP Fier, në pronësi të BEST COSTRUCTION ALB SHPK, në vlerën €ur 18,648 (tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë euro).

• Njësi me Nr. Pasurie 2/346-N2, Vol.27, Fq.8, sip. 138.3 m², z.k 8534, me adresë Lagjja Apolonia, regjistruar në ZVRPP Fier, në pronësi të BEST COSTRUCTION ALB SHPK, në vlerën €ur 69,552 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy euro).

Ankandi zhvillohet dt. 02/05/2019, në adresën, Rruga e Kavajes", Ndertesa 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

Spiropali: Nuk negociojmë, PD ka lënë në rrugë zgjedhësit

Rama mbledh Kryesinë e PS, mazhoranca përgatitet për zgjedhjet, s'ka shtyrje

Kryeministri Edi Rama mblodhi pasditen e djeshme Kryesinë e Partisë Socialiste për të diskutuar rreth zgjedhjeve lokale. Kjo mbledhje, e dyta brenda një jave, u përqendruar tek situata politike, menaxhimi dhe përgatitja për fushatën elektorale dhe përzgjedhja e 61 kandidatëve për Bashkitë. Mbledhja zgjati rreth katër orë, ndërsa përfundoi rreth orës 22:00. Në përfundim të mbledhjes, ministrja për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali, se zgjedhjet lokale të 30 qershorit nuk mund të ndalohen vetëm sepse disa parti politike kanë vendosur t'i bojkotojnë. Ajo se Partia Socialiste do t'i përgjigjet kërkesës për t'u zgjedhur. Spiropali deklaroi se PD i ka lënë në rrugë zgjedhësit e saj, ndërsa shtoi se shumica nuk do të negociojë për të futur atë në zgjedhje "Disa parti kanë vendosur të dalin nga sistemi politik. Ne kemi diskutuar për zgjedhjet e 30 qershorit sepse jemi të vendosur të garantojmë një proces zgjedhor me shqiptarët dhe për shqiptarët. Ne nuk do shkojmë në zgjedhje pa opozitën. Ata janë disa parti politike që kanë zgjedhur të mos marrin pjesë në zgjedhje. Atë vendim e kanë marrë prej frikës.

Ndryshimi

Kuvendi ndryshon formulën për komisionin e reformës zgjedhore pas negociatave me përfaqësuesit e opozitës së re. Nga 18 anëtarë, komisioni i Reformës Zgjedhore bëhet me 10 anëtarë.

Ne mendojmë se shqiptarët duhet të kenë zgjedhje. Ne nuk jemi këtu për të negociuar. Ne jemi një forcë politike që i përgjigjemi kërkesës për t'u zgjedhur. Ne nuk do marrim pjesë në luftë por në zgjedhje. Asnjë forcë politike nuk e ka lënë mendja t'i heqë shqiptarëve të drejtën për të votuar. Është një turp që PD ka zgjedhur që t'i lërë në rrugë zgjedhësit e saj. Është hera e parë që një parti nuk hyn në zgjedhje dhe këtë e konsideron fitore. Ne jemi duke punuar. Sot filloi puna për organizimin në territor. Afati i fundit është 13 Maj. Ne do të bëjmë përzgjedhjet më të mira për shqiptarët. Jemi të vendosur ta çojmë Shqipërisë përpara. Ne do hyjmë në zgjedhje dhe gjithçka tjetër varet nga oferta jonë për qytetarët", u shpreh Spiropali.

Spiropali

"Është një turp që PD ka zgjedhur që t'i lërë në rrugë zgjedhësit e saj. Është hera e parë që një parti nuk hyn në zgjedhje dhe këtë e konsideron fitore. Ne do hyjmë në zgjedhje dhe gjithçka tjetër varet nga oferta jonë për qytetarët".

PS NDRYSHON FORMULËN E 'ZGJEDHORES'

Kuvendi ndryshon formulën për komisionin e reformës zgjedhore pas negociatave me përfaqësuesit e opozitës së re. Burime për Report Tv bënë me dije se nga 18 anëtarë, komisioni i Reformës Zgjedhore bëhet me 10 anëtarë. Anëtarët e PS-së do të jenë Gjiknuri, Gjylameti, Fino, Ferhati dhe Hyseni e ndërsa nga opozita e re do jenë Myslim Murrizi, Nimet Musai, Ralf Gjoni dhe Andi Përmeti. Ky i fundit është edhe themelues i Bindjes Demokratike, ku pritet të betohet si deputet sot në Parlament. Bashkëkryetarë do të jetë Damian Gjiknuri nga PS dhe Korab Lita nga PD. Ndryshimet do të miratohen sot në seancën plenare. Afati i fundit është deri në datë 28 nëntor, përfshirë dhe ndryshimin e sistemit. Më herët, deputeti i grupit parlamentar të të pavarurve, Ralf Gjoni tha se duhen ndërhyrje të menjëhershme në Kodin Zgjedhor, duke shprehur besimin e plotë se do të arrihej një marrëveshje mes opozitës së re dhe qeverisë. Fillimisht, socialistët pranuan që të diskutojnë ndryshime në sistemin zgjedhor në Shqipëri, pas këmbënguljes së deputetëve të rinj të opozitës, se nuk do të uleshin në komisionin e reformës zgjedhore pa u plotësuar ky kusht. Më pas tre grupet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, PS-së, grupi demokrat të drejtuar nga Rudina Hajdari dhe 'Të pavarurit' e drejtuar nga Nimet Musai ranë dakord për zgjatjen e afatit të komisionit të reformës zgjedhore dhe nisjen e debatit për ndryshimin e sistemit zgjedhor. Sa i takon rolit të opozitës së vjetër në këtë proces, kryeministri Edi Rama është shprehur se "Kanë vendin e tyre si vëzhgues me status special. Nuk kemi çfarë bëjmë. Kemi një PD parlamentare dhe një Parti Demokratike rrugore. S'kemi ça bëjmë. Jemi gati të dialogojmë në pitstop me ata".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ndotura", i ndryshuar, Ekipi Përzgjedhës shpall konkurrim për vendin vakant të:

1(një) anëtari të Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit, profesionist sipas përcaktimeve në përputhje me germën "b" të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 8102 si dhe me mandat me kohëzgjatje në përputhje me nenin 4 pika 3/d të po këtij ligji.

Kandidati për anëtar i Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit, në përputhje me germën "b" të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 8102, duhet të jetë profesionist i kualifikuar me diploma universitare dhe të paktën 10 vjet përvojë në ekonomi, biznes, tregti, sistem bankar, kontabilitet, drejtësi, administratë publike apo disiplina të tjera të ngjashme.

Kandidati nuk duhet të jetë në kushtet e papajtueshmërive dhe përjashtimeve të parashikuara nga ligji nr. 8102 dhe legjislacioni në fuqi.

Personat e interesuar të paraqesin kërkesën e tyre, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

1– Deklaratë që kandidati garanton plotësimin e kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 si dhe legjislacionit në fuqi, për Anëtar i Komisionit të sipërpërmendur.
2– Curriculum Vitae.
3– Kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
4– Dokumente zyrtare që vërtetojnë njohjen e gjuhëve të huaja.
5– Certifikata të kualifikimeve të ndryshme.
6– Librezë pune (fotokopje të noterizuar)
7– Certifikatën e Gjendjen Gjyqësore ose Formularin e vet deklarimit të gjendjes gjyqësore dhe kopje te kartës së identitetit.
8– Formularin e vet deklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Dokumentet do të dorëzohen për Ekipin Përzgjedhës brenda datës 08.05.2019 ora 16.30 në adresën:

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, (ERRU) Rr. "Viktor Eftimiu", ish godina e KESH, nr. 1, kati i katërt, Tiranë.

Ralf Gjoni: Nuk do krijojmë parti të re

Grupi i pavarur parlamentar nuk do të krijojë një parti për t'u futur në zgjedhjet e 30 qershorit. Deputeti Ralf Gjoni, tha se ndryshe nga "Bindja Demokratike", nuk do të krijojë një parti "shpejt e shpejt", por ka prioritet ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Ai pranoi se ka pasur inkurajime nga faktorë të caktuar për të krijuar parti politike, por shtoi se ky grup deputetësh ka prioritete të tjera. "Nuk kemi pasur një plan për të krijuar një parti politike për t'u futur në zgjedhje, synimi është ndryshimi i Kodit Zgjedhor. Ka pasur inkurajime nga faktor të caktuar krijimin e një partie politike, por fokusi është ndryshimet në Kodin Zgjedhor. I uroj fat të mbarë përfaqësuesve të çdo partie të re politike, por ne kemi prioritet jo krijimin e një partie politike shpejt e shpejt, por ndryshimin e kodin zgjedhor", tha Gjoni.

Rudina Hajdari thirrje palëve për dialog

Deputetja Rudina Hajdari u ka bërë dje thirrje opozitës dhe mazhorancës të ulen në tryezën e bisedimeve për zgjedhjen e krizës politike. "Marrëveshja ndërmjet partive politike të opozitës për mospjesëmarrje në zgjedhjet lokale, e shikoj si një fatalitet politik. Nga ana tjetër, indiferencën e qeverisë për situatën e krijuar dhe uria absolute e saj për të gllabëruar çdo ditë pushtet, nuk përbën gjë tjetër, veçse shkakun e drejtë për drejtë të kësaj gjendjeje. Sa nuk është vonë të gjithë ata që duan të ardhmen e Shqipërisë, nuk duhet të qëndrojnë indiferentë, por të ulen në tryezën e bisedimit për të gjetur zgjidhjen e shumë pritur", shkruan Rudina Hajdari.

Rea, vajza e Linda Ramës, padit Artur Zhejin dhe 7 portale per shpifje

Spekuluan për një lidhje intime me ministrin në detyrë Gent Cakaj, vajza e gruas së kryeministrit ngre padi

Burime nga Shqiptarja.com mësojnë se ditën e djeshme, Rea Xhillari ka paditur në gjykatë gazetarin Zheji dhe 7 portale të tjera, pas artikujve të publikuar prej tyre, ku shkruhej se vajza e Linda Rames ishte në një lidhje bashkëjetese me Ministrin në Detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. Më poshtë, Shqiptarja.com ju sjell të plotë arsyetimin e Rea Xhillarit dorëzuar në Gjykatë.

ARSYETIMI I PLOTË I REA XHILLARIT:

"Jam detyruar të vë në lëvizje gjykatën për të ushtruar kontrollin gjyqësor, mbi një shpifje të sajuar e të orkestruar ndaj meje, nga portale e individë për të cilët mësova se në gjuhën ligjore quhen "të paditurit solidarë". Ky sulm i mirëfilltë denigrues mbi bazën e një shpifjeje, e ka fillesën në mesin e muajit Janar 2019, kur jam vënë në shënjestër prej të paditurve solidarë. Ata apo më saktë fillimisht Artur Zheji pastaj të tjerët, kanë sajuar dhe përhapur lajmin e rremë, të shoqëruar me komente të turpshme, mbi një lidhje intime apo bashkëshortore timen me Z. Gent Caka, Zv. Minister për Evropën dhe Punët e Jashtme - person të cilin as e njoh personalisht dhe as e kam takuar kurrë ndonjëherë, qoftë edhe rastësisht.

Nuk i njoh as i kuptoj motivet që kanë shtyrë Artur Zhejin, një person në moshë goxha madhore, aq sa mund të ishte prindi im, të më sulmojë kaq ligësisht e paturpësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme. Unë nuk merrem me politikë, nuk punoj dhe as kam punuar kurrë për shtetin. Respektoj cdo ligj dhe cdo detyrim si qytetare e vendit tim. Nuk kam përfituar kurrë prej shtetit asnjë privilegj apo favor të çfarëdo lloji.

I vetmi fill lidhës mes meje dhe botës së shpifjeve, mediokritetit dhe imoralitetit intelektual ku noton ky soj të paditurish solidarë, është fakti se jam vajza e Linda Ramës, e cila nga ana e saj, vetëm për shkak se është gruaja e Edi Ramës, është vënë në shënjestër, goditur, përbaltur nga i njëjti soj, me të njëjtat mjete denigruese të botës së tyre të ulët.

Në fakt, as nëna ime nuk ka përfituar kurrë ndonjë favor nga të qenit gruaja e kryeministrit. Jeta e saj vazhdon e njëjtë, pa asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ose jo, materiale apo financiare me shtetin. Profili i saj është një model shëmbullor i një jete pa privilegje, me një përditshmëri të pandryshuar dhe të lidhur ngushtë me punën e saj, të cilën e kryen me profesionalizëm e pasion prej 30 vitesh, pavarësisht se i shoqi është prej afër 6 vjetësh Kryeministër i Shqipërisë.

Shpifjet kanë arritur deri tek im atë, Thanas Xhillari, profesor i mirënjohur i algjebrës përgjatë gjithë karrierës së tij profesionale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, i cili gjithashtu respekton çdo ligj dhe çdo detyrim si çdo qytetar i këtij vendi. Për interesat politike të atyre që kërkojnë t'i hedhin hije të shkuarës së nënës sime për të shtuar përbaltjen ndaj të shoqit, edhe im atë u përfshi prej të paditurve solidarë, përmes disa pseudoakuzave, në një tjetër maskaradë mediatike. Ai u ballafaqua edhe me një proces të gjatë hetimi nga prokuroria, ku e tërë balta e hedhur mbi të u tret në lumin e fakteve kokëforta që dolën nga hetimi i provimeve të algjebrës, të disa pseudostudentëve që s'kishin marrë dot provimin. Ashtu si nëna ime, babai im është gjithashtu një model shëmbullor i mungesës së kompromiseve që mund të dëmtojnë profesionin e tij të cilin e kryen me pasion e përpikmëri prej 40 vitesh.

Këto modele të cilat janë edhe udhërrefyesi im në rrugëtimin e jetës, siduket janë të papërfytyrueshme , të pabesueshme dhe të papranueshme për sojin e të paditurve solidarë. E vërteta për ta nuk ka asnjë rëndësi, ndërsa interesat e tyre mesa duket justifikojnë çdo mjet sado të ulët.

Por e vërteta mund të vonojë, po nuk harron asnjëherë, megjithëse kur ajo del mbi llumin e të paditurve solidarë këta të fundit refuzojnë ta ndajnë atë me publikun.

"Fenomeni i nepotizmit godet ashpër qeverinë Rama 2 në Ministrinë e jashtme të Shqipërisë. Në rrjetet sociale, dhe disa portale kohët e fundit po flitet gjithnjë e më shumë se vajza e gruas së Kryeministrit Rama, Linda Ramës, Rea dhe Ministri i Europës dhe Punëve të Jashtme-Genti Cakaj, janë në "bashkëjetesë" si i thonë në Shqipëri këtij lloj trendi ..[omissis] Madje, ka edhe dyshime se Ilir Meta-mund të kishte marr informacion nga shërbimet sekrete të sigurisë kombetare të Shqipërisë për këtë lidhje "dashurie" mes Genti Cakaj dhe Rea Xhillarit"...

Kjo është një copëz e nxjerrë nga moria e paragrafëve trillues, të shkruar gjatë këtyre ditëve me një gjuhë të lemeritshme në çdo drejtim, të cilët kam qenë e detyruar t'i lexoj dhe koleksionoj për gjyqin me këtë soj të paftuarish në jetën time.

Unë kam lindur në vitin e ndryshimit të sistemeve dhe nuk e kam njohur përveçse nga tregimet e gjyshërve, prindërve, mësuesve apo dhe nga leximet e rastit, barbarinë e regjimit komunist deri në fisin dhe farën e kundërshtarit politik. Nuk dua të bëj krahasime që çalojnë me një kohë kur edhe lidhjet e dashurisë, bëheshin shkak për pushkatime, internime apo denigrime publike vajzash. Nuk e di nëse në atë kohë sajoheshin për qëllime politike, deri edhe lidhje të paqëna mes njerëzish krejt të panjohur për njëri-tjetrin. Por ajo që di me siguri është se shtrirja e kthetrave të dhunës verbale dhe presionit psikologjik të këtij soji , brez pas brezi, deri tek fëmijët e kujt konsiderohet kundërshtar politik, është shprehje e të njëjtës ligësi kriminale që karakterizon çdo sistem padrejtësie.

Në sistemin që lindi bashkë me brezin tim, personi është privat dhe jo pronë e shoqërisë. Në sistemin që lindi bashkë me brezin tim, gjëja e parë që mëson është se liria jote mbaron aty ku fillon liria e tjetrit. Sajimi i një lidhjeje të paqënë mes dy te rinjsh për të luftuar politikisht me prindin e njërit prej tyre, është një perversitet i pashoq që s'ka asnjë lidhje me këtë sistem. Unë nuk kam asnjë armë tjetër për t'u mbrojtur nga pasojat e këtij perversiteti, përvecse duke i'u drejtuar drejtësisë".

Rea Xhillari

Përgjigjia e gazetarit

Zheji reagon pas padisë: Xhaxhi Edi kërkon të na përdorë të dyve

Gazetari Artur Zheji ka reaguar pas padisë së vajzës së Linda Ramës, Rea Xhillari, në drejtim të tij dhe shtatë portaleve të tjera, pas artikujve të publikuar prej tyre, ku shkruhej se ajo ishte në një lidhje bashkëjetese me Ministrin në Detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. Në përgjigjen e tij publike Zheji pranon se ai thjesht ka dëgjuar për këtë lidhje duke cituar disa "linke" nga media online dhe se nuk është burim i lajmit. "Po të bësh ti Rea, një kërkim të pavarur, do të shohësh se unë personalisht nuk të kam përmendur kurrë, përveç ditës së sotme, dhe portali që unë drejtoj me 1001 vështirësi, nuk ka qenë asnjëherë burim, e aq më tëpër sajues i një lajmi të tillë. (shiko links në fund të shkrimit)" thekson Zheji, I cili më pas akuzon Rean se padia ndaj tij është bërë nga kryeministri Rama, "xhaxhi Edi" siç e quan Zheji me ironi. "Por shoh përtej mjergullës dhe me trishtim të thellë, se xhaxhi Edi, kërkon të na përdorë të dyve, në një gërshetim të panatyrshëm, ku ti je "viktima" dhe unë xhelati, dhe kjo është e pafalshme, të paktën në Perëndim..."

Ministri

Gent Cakaj: Nuk kam asnjë lidhje me vajzën e Linda Ramës

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj ka mohuar lajmet, se ai është në një marrëdhënie sentimentale me vajzën e Linda Ramës. Në një intervistë për emisionin "Opinion" me gazetarin Blendi Fevziu, Cakaj tha se lajme të tilla janë dashakeqëse dhe do të përballet në Gjykatë me autorët e kësaj shpifjeje. "Kjo përveç se është absolutisht e pavërtetë është edhe dashakeqe. Me autorët e kësaj do ballafaqohem në gjykatë. Kanë bërë gjithfarë obstruksionesh me këtë çështje. Kjo është një gënjeshtër absolute bëhet për të njollosur kryeministrin dhe reformën në ministrinë e jashtme. Kjo korrespondon dhe me një iniciativë që kemi marrë në ministri që është lufta kundër nepotizmit dhe klaneve në diplomacinë shqiptare. Janë klane të caktuara po spekulojnë. Unë jetoj vetëm dhe nuk jam në një lidhje. Kjo është produkt i fantazisë së shfrenuar dhe unë turpërohem të as për këtë çështje" – tha Cakaj.

ANALIZA

Ëndërra e fshehur e fashistëve për t'u hakmarrë



NGA **BAJRAM PEÇI**

Me të ndjerin Sabri Godo kam patur një miqësi që rridhte nga kohërat e Luftës Nacional-Çlirimtare. Së bashku me "kriminelin" numër 18 të listës së 265 të tillëve, që ka hartuar një bandë "shkencore" që ushqehet nga qeveria, me dëshmorin Balil Peçi, vëllai i tim eti, kishin qenë partizanë të çetës së rinisë të Gjirokastrës. Më pas, të Brigadës së VI-të, të inkuadruar në batalionin "Baba Abaz", ku Balili mbajti për tre muajsh detyrën e zv/komandantit. Po me Sabriun luftuan së toku në Labinot-Fushë në betejën e datës 11 shtator 1944, kundër autokolonës gjermane. Sabriu, djalosh i pa rritur ende mirë, ishte i pranishëm në momentin kur Balili u vra në luftë e sipër. Zv/komandanti i Sabri Godos ishte pak vjet më i madh se shoku i tij, 22 vjeç kur ra theror në luftë kundër okupatorëve fashisto-nazistë. Për interesin e vet e atë të kombit, asnjë ballist i "Institutit" të turpit të mos e gënjejë mëndja se do bindë ndokënd që djaloshi 22 vjeçar, me emërin Balil, ishte një kriminel. Ai ishte e do mbetet një ish luftëtar që dha jetën e tij në lulen e rinisë për lirinë e atdheut.

Ndërsa Balil Peçi, nën breshërinë e armëve të bashkëluftëtarëve, u varros në Labinot me nderime, Sabriu luftoi deri në çlirimin e plotë të vendit, për të cilin dha ndihmesën e tij si krijues në letërsi, si deputet dhe kryetar kuvendi. Personaliteti i tij sot nderohet e kujtohet me një bust para kuvendit, atij kuvendi ku para disa ditësh ballisto-fashistët do e shpallnin xhaxhain tim kriminel. Të gjitha këto, kaq pafundësisht larg për fëmijët e nipat tanë, i sjell në aktualitet një institucin buxhetor, një institut i ngarkuar që të studiojë krimet e komunizmit. Me paradokset që tjerr "shkenca" e qelbësirave hakmarrëse e që duket qartë se kërkon të helmojë të vërtetën, moralin, virtytin, gjykimi i shëndoshë i shqiptarëve duhet t'i dërgojë përpos se në çmendinë. Të ndjerë të pazotë për të ndryshuar historinë, i vetmi kompensim që këta të neveritshëm mund t'i bëjnë vetes është të rrisin ëndrrën e fshehur gjatë për t'u hakmarrë ndaj atyre që i shohin fajtorë që Gjermania humbi luftën e që pasoi me mjerimin e tyre. Dhe këta fajtorë s'mund të jenë kush tjetër veç luftëtarëve që luftuan kundër nazifashizmit?!

Pasi u bë publike lista e ndyrë e hakmarrjes klasore, pyesja veten si duhet të sillesha. A nuk do ishte më me vend të dëgjoja ata që shkruanin e shprehin qendrimin se nuk duhet marrë me një tufë budallenjsh, "varu pafidhen", siç e shprehu një sociolog i nderuar, apo të shkruaja? Mirëpo, nga këto gjirize, heshtjen shpërfillëse ta marrin si stepje, si druajtje. Bëra çmos për të zbritur me këmbë në tokë. As tani që jam këtu, me "penën" në dorë, nuk u zemërohem dot me fyerje poshtëruese, por as nuk qesh dot. Ajo që dalloj te lista me mendimin "shkencor", e strukturuar thellë në fundin e ndërgjegjes të bashkëpuntorëve të fashizmit në një institucion, është ndërgjegja e verbër e gjithë atyre që lejon sot fondet qeveritare të priren si shpenzim drejt nxitjes së hakmarrjes.

Një nga gjërat më të vështira në botë është të marrësh me mend se deri ku shkon urrejtja e të mos parashikosh dot se çka vërtitet në trurin e tyre të infektuar, nga qëllimi për përmbysjen e sistemit të vlerave. Aq verbërisht iu nënshtrohen synimeve, sa nuk druhen të

përdorin për këtë një të ashtuquajtur institut, ku ajkës ballisto-fashiste u rezervohen pagesa mikluese prej taksave të familjes shqiptare.

Beteja e ndërmarrë për të çrrënjosur kujtesën, ka fituar tiparet e institucionit shtetëror. Kështu ndodh kur shikohet se si vlerat shkelen me këmbë, se si shoqëria nuk është e aftë të vërë re se antipatia, duke ndërmarrë hartime listash me pothuaj gjithë komandantët e luftës Nacional-Çlirimtare, për t'i shpallur kriminelë, është shndërruar në urrejtje për hakmarrje.

Kurveleshi, krahina nga kanë origjinën prindërit e të parët e mi, xhaxhai Balil Peçi, është vendi që mbajti një peshë të madhe të luftës. Vuajti mjerimin, mbi të rënduan krimet e shfarosjes hitleriane e ku gjaku u derdh lumë. Në fund të luftës asgjë nuk kish mbetur prej saj, gjithçka ishte djegur e përvëluar, shtëpi, bagëti e katandi. Lulja e rinisë kish dhënë jetën për mbrojtjen e tokës e lirisë. Pat ardhur në Kuç, fshat i origjinës të prindërve të mi, në vitin 1942 një batalion italian me emërin "Peruxhia" dhe i kish vënë flakën fshatit si vendbanim, ku i bëhej rezistencë pushtimit. Këtij batalioni, të cilin pas kapitullimit gjermani e shfarosi po në fshatin tonë, qeveria demokratike i ngriti një memorial, por as sot e kësaj dite fshati im nuk ka një memorial për 110 dëshmorët e saj. Fronti i luftës italo-greke, shtrirë mes palëve nga jugu në veri të Kuçit dhe operacioni gjerman i qershorit, nuk la më gur mbi gur. Nuk është aspak e tepërt të përmend se gjyshi im, i kish dalë për zot vatanit, kur Ai e kish thirrur. Meto Peçi, babai i "kriminelit" me nr.18, Balilit, kish drejtuar në luftën e Vlorës, më 1920, çetën prej 200 luftëtarësh të Kuçit dhe kur Shqipëria u pushtua, nuk priti partinë komuniste (që as e njihte) t'i kërkonte djemtë për luftë. Pesë djem të tij i bekoi dhe i nisi për t'u rreshtuan në formacionet partizane të Brigadës së I, të VI-të dhe batalionit Ismail Haki. Me 1999, fshati im, që më jep nder, Kuçi, së bashku me fshatin Pezë, u shpall nga Unioni Botëror i Paqes në Bolonjë, "Fshat Martir" i Luftës së Dytë Botërore. Ishin djemtë e fshatit tim e të krahinave të tjera të Shqipërisë, që e renditën vëndin tonë të mjeruar nga hordhitë hitleriane, në kahjen e fituesit. Ndryshe...falna Zot, nuk do ekzistonim!

Doktor Goebbelsi, ministri i regjimit racist të Rajhut të III, porosiste pa rreshtur se nëse hedh baltë ndaj dikujt, gjatë dhe sistematikisht, atëhere domosdo ca copa balte viktimës do t'i ngjiten. Instituti fashist e di këtë, ndaj synimin e ka te përdhosja e luftës Nacional-Çlirimtare. Ishte pikërisht kjo luftë, në mbarim të së cilës u shemb kolonializmi, u përmbysën sisteme politike dhe ekonomike. Të humburit, as kanë harruar, as falin! Tani, që e vërteta historike e kësaj periudhe është lënë pa kujdes, e braktisur, humbësit e ish pushtetit të shëmbur, me strukturë feudale e thellësisht të prapambetur, kërcënojnë hakmarrje, kërcënojnë paqen sociale. Shëmbulli është përdhosja e heronjve përmes listash, gjuha e shpifjeve për të nëpërkëmbur historinë dhe dinjitetin.

Fatin e përbashkët, historinë, e lidh kujtesa, e lidhin vlerat e trashëguara. Te ky atdhe, që kemi patur shumë besim, këto lista "kriminelësh" përjetojnë dhimbjen, kur shihet se brënda atdheut shpirtëror, që nuk duket se është i lirë t'u tregojë vendin gjithë zuzarëve të ngjallur, pinjollë të bashkëpunëtorëve të fashizmit. Nën trokëllimën e kokave boshe të atyre që detyrohen të jenë mbrojtës të Luftës Nacional-Çlirimtare, ndjehet tolerimi në heshtje i shpifësve, që orvaten të grabisin monopolin e të vërtetës. Nuk e gjen dot një përgjegje të saktë, veç prononcimit të një deputeti. E shohin se instituti është shndërruar në një nevojtore të madhe ku çdo ballist e ish bashkëpuntori i fashizmit vjet të jashtëqisë të pëgërat e tij mbi historinë, luftëtarët heroikë e të rënët për liri. Pse heshtin? Asnjë listë e "shkencë" nuk do jetë e aftë të pastrojë ndërgjegjen tuaj nga bashkëpunimi me okupatorin, o të mjerë!

Nën peshën e jehonës së kobshme që sjell lista për hakmarrje, prania e kësaj vrime gjirizi me emërin "Institut", ka tërhequr vëmendjen e një shtrese te madhe poullate, që familjet e tyre i lidh me luftën. Kur një shqiptar don ta turpërojë shqiptarin tjetër, t'i marrë nderin atij, më ndjeni, por dëshminë e urrejtjes e shfaqin duke sharë me ta bëfsha nënën, gruan, motrën, vajzën. Këtë kanë bërë dhe komentuesit. Unë, jo se nuk i kam thënë kurrë në jetën time, por, në këtë rast, as që i hamendësoj si mundësi përdorimi. Ajo që më shkon ndërmend është çuarja e këtyre delenxhinjve para një trupi gjykues, në dhunim të nenit 29 e 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. U bëj thirrje të gjithë trashëgimtarëve të kësaj historie të lavdishme, të asaj kohe që u ka dhënë nder, që kanë kohën, moshën dhe mundësisht paratë, të organizohen për të hapur ndaj shpërdoruesve të detyrës çështje penale! Historia do jua dijë për nder.

Në subkoshiencën kolektive të kësaj bashkësie turpi, këta humbësa të mëdhenj, të rreshtuar dikur ushtarakisht në kahjen e gabuar dhe sot të rreshtur politikisht, me qëllimin për t'u pastruar, duke nëpërkëmbur luftën dhe heronjtë e saj, për të fituar legjimitetin moral (të humbur para 75 vjetëve), do ta kenë përsëri të humbur. I sigurojmë për këtë, me institute që kutërbojnë erë të qelbur apo pa institute qofshin. Gjithsesi, o popull, kujdes, këta kafshojnë!

Mjeshtri Kodra shpallet misionar dhe ambasador i paqes në SHBA

Kujtimet me piktorin e madh shqiptar në Itali. Çfarë më ka rrëfyer gjatë një interviste ne studion e tij dhe apeli për paqen në intervistat me gazetarët italianë kur e pyesnin për çështjen e Kosovës gjatë luftës

Nadire Buzo
TIRANE

Duke u mjaftuar me jetën e përditshme dhe asaj që na rrethon, harrojmë t'ju referohemi njerëzve, imagjinata e të cilëve është e thellë, e lartësuar dhe e jashtëzakonshme.

Është koha kur njerëzimi e ka humbur drejtpeshimin, fillin e arsyes, e aq më shumë largohet prej të lartësuarës. Harron për ca kohë se në vendin e tij apo në botë kanë ekzistuar dhe ekzistojnë njerëz fisnikë e të arsyeshëm që aftësitë dhe artin e tyre e venë për të lartësuar ndjenjën e shpresës së mirë, të bashkëpunimit, të solidaritetit, midis njëri-tjetrit për një jete më dinjitoze.

Artistët dhe humanë të përmasave, si Ibrahim Kodra, do të vlerësohen gjithmonë, mendimet dhe kujtimet për ta janë të pashtershme. "Unë kërkoj larg në horizont/ praninë e jetës/pafundësinë.../ lëvizjen....."

Pikërisht, një javë në parë më 13 Prill, 2019; Misioni Diplomatik për Paqe dhe Prosperitet (DMPP), Akademia e Paqes Globale (AUGP) të Kombeve të Bashkuara, Misioni Diplomatik Amerikan për Paqe Botërore (ADMËP), i Shoqërisë Diplomatike Shën Gabriel (DSSG) dhe Universitetit të Kombeve të Bashkuara për Paqe Globale (UNUGP), i akorduan Mjeshtrit Ibrahim Kodra, Titullin e Merituar "Ambasador nderi i Misionit Diplomatik për Paqe dhe Prosperitet" (Pas vdekjes). Nderimi iu bë me motivacionin si Piktor madh i njohur ndërkombëtarisht në shërbim të Paqes Sociale dhe Prosperitetit Social. Për angazhimin e madh dhe kontributin e çmuar në Arte, për frymëzimin e patriotizmit dhe bashkëveprimit ndërkomunitar të paqes.

I dekoruar me urdhrin Nderi i Kombit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si Ambasador i Kulturës Shqiptare, Si misionar Global i Paqes dhe Ambasador Nderi i DMPP, si filantrop, e udhëheqës i vetësakrifikuar dhe nxitës i misioneve që sjellin paqe dhe begati për gjithë njerëzimin, Ibrahim Kodra tashmë është Luftëtari i Paqes. Për shumë vite ai ka kontribuar në paqen sociale në Shqipëri dhe në mbarë botën, duke ofruar mbështetje sociale, edukative dhe humanitare. Ka dhënë kontribute në fushën e artit, edukimit, patriotizmit, lirisë nga diktatura. Nderimi iu bë me konsideratën më të lartë nga Guvernatori DMPP, Dr. Shefki Hysa; Krishan, Ambasador Nderi I ADMËP, Guvernator Ndërkombëtar i AUGP; Ambasador Prof. dr. Madhu. kryetar I AUGP-Patriak. Titulli i nderit, iu dha piktorit të madh me propozimin e Kryetarit të shoqatës kulturore " Ibrahim Kodra të Ishmit z. Lulzim Bega. Ishin të pranishëm, përveç titullarëve të mësipërm edhe, Dr. Dylbere Dika, Drejtore e Përgjithshme e DMPP, Dr.Kristo Goci, Zëvendëskryetar i Komitetit Shtetëror te Minoriteteve, Prof. Dr.Sulejman Abazi Gjeneral i Paqes, Zotëria Asllan Mazreki, Gjeneral i Paqes, Kolonel Zaho Golemi, si dhe Misionarët e Paqes: Dr. Idriz Balani, Veli Myftari, piktori Sulejman Prenjasi dhe shumë personalitete të Artit, Kulturës dhe Shoqërisë Civile Shqiptare! Bashkëfshatarë dhe intelektualë të nga Durrësi, Ishmi dhe Tirana, miq dhe të afërt të Mjeshtrit Kodra.

Tek dëgjoja motivacionin gjatë të dhënies së titullit, mendimi më fluturoi tek korridori i thjeshtë i Mjeshtrit, ku mbi një raft të gjatë mbërthyer në mur si sergjenët e shtëpisë së Ishmit, ishin radhitur trofetë dhe çmimet pa fund që mjeshtri i madh i përfshirë në enciklopedinë botërore, si një nga 30 piktorët më të mëdhenj të botës, i quajtur nga kritika e lartë botërore si ''Pikaso i gjallë".

Më shumë se 30 shtete kanë bërë filma dhe dokumentarë për Mjeshtrin që është "Qytetar Nderi" në shumë qytete të Italisë dhe botës, si në Gjermani, France e deri në Tokio. Çmime e trofe pa fund nga e gjithë bota. Midis tyre edhe medalja "Milanezi i Artë" që ia dorëzoi Kryetari i bashkisë, Gabriele Albertini, në konkursin kombëtar për arkitekturën. Mjeshtrin, studentin e quajtur "Ylli i Breras" në Akademinë ku studioi në Milano, e preokuponte gjithçka. Edhe betonizimi i qyteteve në të cilat është shumë vështirë të banohet.

RRËFIMI I IBRAHIM KODRËS PËR VENDLINDJEN

"-Kam lindur në Ishëm unë. Jam ishmak. E Ishmi është afër Durrësit e Tiranës. Nga Kodra e Ishmit shihet Tirana, Durrësi, Lezha, Mamurasi, Kruja dhe një pjesë e mirë e Detit Adriatik, deri në Ulqin e më tej. Është vend i bukur apo jo. Kështu fillonte biseda dhe prezantimi me të panjohurit qofshin ata artistë të mëdhenj apo personalitete të larta të vendit e të huaja, miqve dhe mikeve të tij të dashura, të cilave u fliste për nënën, Ishmin, rakinë, Arbërinë dhe Kalanë madhështore të Heroit Legjendar Skënderbeut.

Ishte mik i ngushtë i Pikasos, i cili bënte pjesë në sërat e larta të elitës Franceze, ndërsa Kodra vinte nga një vend i varfër, i cili u pushtua nga fashizmi e nazizmi e më pas nga komunizmi.

"-Pikaso përdorte shpesh tridimensionizmin, unë mendova teorinë time. Ku ka një vijë vertikale, duhet të mbështetet pa tjetër tek një vijë horizontale, pra kubizmin katërdimensional. Pasi në atë kohë u prezantua koha e konsumizmës në botë, e cila e la njeriun viktimë, kjo është anatema e atij civilizimi, njeriu është ''njeriu robot"."., më thoshte Kodra.

Mik me Pol Elyarin, Heminguein, Dino Buxatin, Gutuzon, Kuazimondon, e shumë shkrimtarë, poetë, politikanë arkitektë dhe njerëz ë thjeshtë me të cilët kalonte kohë të gjata me ata dhe ju tregonte shumë herë për vendin e tij, për Shqipërinë.

"- Iu thosha se asht nji vend i bukur sa s`ka ma."

Në Itali shkoi në një moshë shumë të re. Atje u pagëzua me fenë kristiane, por asnjëherë nuk e ndërroi emrin dhe mbiemrin e tij, as atëherë kur miqtë e kështillonin të përshtaste një emër arti, siç bëjnë artistët e mëdhenj. Ai nuk pranoi. Dhe vetë firma e Mjeshtrit ishte një art më vete.

"-Edhe fenë edhe emrin i kam për të qenë përbrenda identitetit tim."-u thoshte shpesh miqve të tij.

Mjeshtri ishte një luftëtar i paqes, ashtu si thuhet në motivacion. Shumë tablo të tij janë të frymëzuara nga veprat e Heminguejt, Folknerit, Frederiko Garsia Lorka, ilustrime nga vepra e Brehtit, si "Homazh për Bertol Breht". Në tablo shkruante shpesh në krye të tablosë, "Pace". Gërmat e kësaj fjale kodifikonin shpesh pikturën e tij.

IBRAHIM KODRA, NJË LUFTËTAR I PAQES SA ISHTE GJALLË...

Ibrahim Kodra ishte një luftëtar i flaktë i çështjes kombëtare. Në morinë e gazetave dhe revistave, të shtypit të rëndësishme italian, sheh shkrime dhe intervista ku mjeshtri Kodra jepte mendime dhe vlerësime

për shumë probleme kulturore, sociale dhe politike. Syri të zë një nga gazetat që ai ka afishuar në murin e studios. “Le Voce di Mantova. 1998” (Zëri i Mantovës), ku me germa të mëdha kapitale boton thirrjen dhe apelin e Mjeshtrit, si një nga përfaqësuesit më të lartë të artit dhe qytetërimit shqiptar. Ai, i bën apel OKB-së, Presidentit të SHBA Z. Bill Klinton dhe Parlamentit Europian, që të ndërhyjnë urgjentisht për t’i dhënë fund operacioneve të vazhdueshme të spastrimit etnik në Kosovë, në mënyrë që të mbrohen dhe të ruhen vlerat njerëzore, etike, fetare, të një kombi që po sakrifikohet në altarin e egoizmit, të urrejtjes kulturor të një kombi, të cilin po e vë përfund barbaria, tmerri dhe terrori.

“-Po Zoti kur na krijoi tha: ’’Unë ju kam krijuar për të jetuar e jo për të vdekur”. Sërbët po i shkelin fjalët e Zotit, ata janë dhënë pas krimeve dhe shkatërrimeve, sepse e quajnë veten hyjni. Të tjerët s`janë veçse krijesa inferiore, skllevër që meritojnë të poshtërohen dhe tiranizohen.

Sllobodan Miloshevici nuk tregon asnjë interes për veçantitë dhe dallimet që karakterizojnë shqiptarët e Kosovës .”, thoshte Kodra.

Gazetari italian e pyet Mjeshtrin, nëse është dakord për luftën e luftëtarëve të Kosovës. Ai ju përgjigj pa mëdyshje:

“-Po luftë për çlirimin ndaj një kriminaliteti të ri. Në Kosovë po eksperimentohet një tip i ri kriminaliteti në kërkim të kënaqësisë vrastare dhe egoizmit. Masakra e Reçakut është pasojë e këtij tipi të ri kriminaliteti që qëndron shumë larg ligjeve humane dhe hyjnore. Kushdo që gjymton, copëton dhe masakron kufomat, nuk është veçse një lloj i ri kanibali. Edhe për sa kohë popujt e civilizuar do të tolerojnë të tilla turpe! Sllobodan Milosheviçit i intereson vetëm që në Kosovë të ndajë bijtë nga baballarët dhe trupat nga kryet. Ai kërkon vetëm të përvetësojë të mirat e shqiptarëve, të shumëfishojë urrejtjen racore e të realizojë procese gjyqësore të cunguara.”

Gazetari i “La Voce di Mantova”, e pyet përsëri, se në ç` mënyrë duhet të ndërhyjë komuniteti ndërkombëtar për t’iu dhënë fund krimeve që kryen në Kosovë.?

Mjeshtri, përgjigjet me vendosmëri:

“-Sot njeriu nuk është më një krijesë primitive, ai duhet t’i zgjidhë problemet nëpërmjet fjalës dhe diplomacisë. Unë gjithnjë kam luftuar që Shqipëria të bëhet një komb neutral sikurse Zvicra. Sot këtë e dëshiroj edhe për Kosovën. Këto troje shumë shpejt do të përshkohen nga naftësjellës e gazsjellës që nga lindja do të çojnë energji deri në Detin Adriatik. Prandaj është emergjente që këto toka të mbeten neutrale e në këtë mënyrë të shmangin rreziqet që kërcënojnë Europën dhe botën mbarë.

Vetëm mbi këtë bazë mund të zhvillohet debati ndërkombëtar, që do të bëjë ë mundur pajtimin mes shqiptarëve dhe serbëve. Unë uroj që Kosova të fitojë lirinë që meriton, sepse ka një popull krenar për vlerat e tij, për kulturën dhe historinë e tij. Popujt e Kosovës kanë të drejtë të bashkohen e të jetojnë si një familje e madhe, e lirë dhe e pavarur.”, thoshte Kodra

Mjeshtri Kodra, viziton Kosovën ne vitin 2002, ku iu bë një pritje jashtëzakonisht e mirë. - Kosovarët i dua shumë, janë trima dhe mikpritës, historia e Kosovës është e dhimbshme. E ëndërroj pavarësinë e saj, kam shkruar një vjershë (e reciton me lot ne sy: Shqipja flutroj dhe me krahët e saj në fluturim, shkroi në qiell emrin Liri dhe Arbëri.).

Humanizmi njerëzor e karakterizoi vazhdimisht, mbështeste studentët shqiptarë që studionin në shtetin fqinjë. Ndihmonte njerëz që nuk kishin mese të ushqeheshin. Dikur kishte ndihmuar tregtarë në hapjen e restoranteve, më pas kur ata nuk mundën t’ia kthenin nuk rebelohej, po dërgonte njerëz me firmën e tij të ushqeheshin falas atje. Ndihmoi dhe promovoi piktorë të rinj. Lartësoi pa rezerva dhe xhelozi, figura të larta të kombit, me të cilët krenohemi kudo ndodhemi.

Është mbresëlënëse dhe paharrueshme për qytetarët e Palermos, restaurimi i teatrit “Masimo”, atje ku u luajtën kryeveprat e Verdit e ato botërore. Pas diegies totale, Teatri u restaurua tërësisht me riprodhimin dhe shitjen e dymbëdhjetë tablove të tij “Muzikantët”. Ndaj kur u inaugurua teatri i ri. Kryetari i baskisë, Leoluka Orlando, e filloi me fjalën “Urime”. Kjo është fjala e Pagëzimit Shqiptar.

Pavarësisht çmimeve dhe dekorimeve të shumta nga mbarë bota, Mjeshtri Kodra vlerësonte mbi gjithçka, çmimet dhe vlerësimet që i bëheshin në vendin e tij, Shqipëri.

Ndaj vlerësim i bërë nga Misioni Diplomatik për Paqe dhe Prosperitet i njeh Ibrahim Kodrës vlerat e larta, humane. Ashtu si dhe theksonte dhe vetë Mjeshtri: “Arti është liri, sepse nëpërmjet tij në prekim natyrën dhe gjithë bukuritë natyrore, të cilat janë armiq për çdo sëmundje. Arti na dhuron gëzimin e të jetuarit, na dhuron atë gjendje shpirtërore, pa të cilën ne nuk do të mund t’i bënim ballë ankthit dhe mllefit të përditshëm. Të kultivosh art, do të thotë të mbetesh i ri. Në përgjithësi, sekreti i të qenit në harmoni me jetën, është inteligjenca krijuese e aftë t’iu ofrohet të tjerëve me modesti, pa ambicie të shfrenuara dhe arrivizëm, që krijojnë vetëm strese dhe sëmundje.

Nga të gjitha këto fakte dhe vlerësime, ai është dhe poet. E pakrahasueshme poezia, “Unë Kërkoj.” Ku shpreh qartë karakterin e tij të veçantë të një artisti të madh. Ja një fragment i saj: “Unë kërkoj mekanizmin e gjithësisë/misterin e ajrit/të flladit/të agimit të mëngjesit./Unë kërkoj të mbjell tokë/lulen e parë/farën e parë/të së ardhmes.”

PROMOVIMI

Regjisori Anagnosti promovon librin “Ulliri, pema e dhimbjes”

Lexuesi tanimë ka në duar librin e një mjeshtri. Kështu e ka cilësuar botimin e ri “Ulliri, pema e dhimbjes” të kineastit Dhimitër Anagnosti, studiuesi Shaban Sinani. Etyde, skica, ditar, rrëfime dhe tregime e novela vijnë nëpërmjet këtij botimi, që mesaduket edhe për kritikën, rrëfejnë se si “Shqipëria letrare është më e bukura nga të gjitha Shqipëritë: politike, ideologjike, ekonomike dhe historike”. Bashkëshoqëruesja e tij më e afërt në skenë edhe në jetë, aktorja Roza Anagnosti, edhe pse një jetë me mjeshtrin e kinemasë, mes emocioneve ajo përshkruan, se ky libër është një gëzim i madh, sepse artisti nëpërmjet tij do të takohet me lexuesit, që adhurojnë veprën e tij.

“Do të dëshiroja me gjithë zemër, që të ishte një takim i ngrohtë. Ky është edhe qëllimi i botimit të këtij libri. Jam e gëzuar që arriti ta materializojmë këtë libër. Është gëzim për një krijues, një kineast, që jo nëpërmjet filmit, por nëpërmjet librit do të takohet me lexuesit, që adhurojnë veprën e tij. Anagnosti ka shkruar 20 skenarë, prej të cilëve dy janë botuar, ndërsa kjo është vepra e katërt, pas romanit “Koburja nga Europa”. Ishte një nxitje e brendshme, e mesa duket erdhi momenti, që Dhimitri të na përcillte emocione të reja. Vepra është botuar si një sintezë, është vazhdim i krijimtarisë së tij, si kineast, skenarist dhe shkrimtar. Është edhe një homazh për të gjithë ata artistë të shquar, që nuk janë më, por që kanë lënë veprat e tyre. Dhimitri është i kursyer në fjalë, por jo me ndjenja edhe filozofinë e tij. Siç thotë ai: “Unë punën time e kam kryer, tani libri është në dorën tuaj, jeni ju që do ta gjykoni”, shprehet aktorja Roza Anagnosti.

Ndërsa, për fjalëpakun, të urtin dhe të palodhurin Dhimtër Anagnisti ky libër është një tjetër mision i përmbushur prej tij, për t’i ardhur sadopak në ndihmë kujtdo, që do të njihet me vlerat e pashuara të një kombi në kinematografinë shqiptare.

“Është kënaqësi, që pas kësaj pune, të kemi dhe të tjera punë, si ajo punë krijuese që kemi bërë dikur. Kështu mund të bashkëjetojmë edhe të bashkohemi përmes artit me artin. Shqiptarët kanë identitet të mrekullueshëm, kanë talente edhe shpresojmë që të vazhdojmë që të vazhdojmë kemi shkrimtarë, piktorë, muzikantë edhe kineastë të mirë”, u shpreh kineasti i njohur.

Gjatë promovimit të librit artistët Robert Radoja, Mehdi Malkaj dhe Kristian Koroveshi lexuan pjesë.

VA. DE.

Kompensimi i pronarëve, qeveria bën ndryshime në VKM të mëparshme

Korrigjohen emra pronarësh, sipërfaqja e kompensuar për efekt legalizimesh

Këshilli i Ministrave ka bërë në një nga mbledhjet e tij të fundit korrigjimin e disa të dhënave lidhur me legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje dhe kompensimin e pronarëve të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen A, të vendimit nr.389, datë 19.5.2010, në zonën kadastrale 8521, për pasurinë 13/14 zvogëlohet sipërfaqja e kompensimit.

2. Në lidhjen B, të vendimit nr.378, datë 25.5.2016, në zonën kadastrale 8526, për pasurinë 383/1/29 (383/104) zvogëlohet sipërfaqja e kompensimit.

